

*Procesverbali i zbardhur i seancës së shortit  
për përzgjedhjen e ekspertëve kontabël  
Dt.18.03.2022*

18.03.2022

Ora 12:09

**RENDI I DITËS**

*Shorti “Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesit ligjor), të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore, si dhe kandidatët për kryetar bashkie, për fushatën zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022”.*

**PJESËMARRJA :**

- **Stafi KQZ: Y. Merkaj, K. Puleri**

*Z. Y. Merkaj:* Përshëndetje të gjithëve! Sot, në datën 18 mars 2022 do të zhvillohet seanca për shortin për përzgjedhjen e ekspertëve kontabël të licensuar që do të auditojnë fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore në zgjedhjet e datës 6 Mars 2022. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në vlerësim të rëndësisë dhe transparencës së procesit dhe në zbatim të vendimit nr. 15 datë 26.02.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ka bërë njoftim publik në faqen zyrtare të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve për pjesëmarrje për të gjithë aplikantët, të cilët shfaqën interes për të qenë ekspertë kontabël të licensuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga subjektet zgjedhore, si dhe kandidatët për kryetar bashkie, për fushatën zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022. Në zbatim të vendim nr. 15, datë 26.02.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kanë depozituar dokumentacionin tre aplikantë të interesuar për ekspertë kontabël të licensuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga subjektet zgjedhore, si dhe kandidatët për kryetar bashkie, për fushatën zgjedhore të datës 6 Mars 2022. Aplikantët plotësojnë kriteret e përcaktuara te

*Zbardhi materialin nga shënimet  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës së shortit  
për përzgjedhjen e ekspertëve kontabël  
Dt.18.03.2022*

vendimi nr. 15, datë 26.02.2022. Pas miratimit të listës paraprake të aplikantëve u njoftuan të gjithë kandidatët e përzgjedhur dhe sot në datë 18.03.2022 do të organizojmë shortin online, për përzgjedhjen e ekspertëve kontabël të licensuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga subjektet zgjedhore, si dhe kandidatët për kryetar bashkie, për fushatën zgjedhore të datës 6 Mars 2022. Në një enë transparente do të vendosen pesë shirita me emrat e subjekteve zgjedhore, të cilat pasi të lexohen do të futen në gogla me formë, ngjyrë dhe masë të njëjtë. Tek ena tjetër transparente do të vendosen tre shirita me emrat e ekspertëve kontabël të licensuar. Duke qenë se janë pesë subjekte zgjedhore dhe tre ekspertë kontabël të licensuar të përzgjedhur, ndarja do të bëhet dy ekspertë kontabël të licensuar do të auditojnë nga dy subjekte zgjedhore dhe një ekspert kontabël i licensuar do të auditojë një subjekt zgjedhor. Përzgjedhja do të bëhet duke tërhequr nga njëra enë transparente emrin e ekspertit kontabël të licensuar dhe nga ena tjetër transparente emrin e subjektit zgjedhor.

Fillojmë procedurën e shortit. Në fillim tërhiqet gogla tek emri i ekspertit kontabël nga një nëpunës i KQZ-së.

Ekspertia znj. Silvana Gjikhima:

Tërhiqen dy gogla tek ena transparente me goglat e subjekteve zgjedhore.

- a) Partia Socialiste e Shqipërisë;
- b) Partia Demokratike.

Ekspertia znj. Meri Lika:

- a) Partia Lëvizja e Re;
- b) Partia Demokristiane e Shqipërisë.

Ekspertia znj. Fatmira Kastrati:

- a) Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.

*Zbardhi materialin nga shënimet  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës së shortit  
për përzgjedhjen e ekspertëve kontabël  
Dt.18.03.2022*

Këtu përfundon dhe procedura e shortit për përzgjedhjen e ekspertëve kontabël të cilët do të auditojnë fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore në zgjedhjet e datës 6 Mars 2022, faleminderit!

**Vendimi nr. 138**

*Zbardhi materialin nga shënimet  
Merita DULAKU*

